



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

## DREJTUESJA E PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR PUKË KONFIRMOHET NË DETYRË

Më datë 26.04.2019, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Znj. Elidiana Kasa, me detyrë Prokurore/Drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Trupi gjykues, informoi në fillim të seancës se subjekti rivlerësimit i është nënshtruar hetimit administrativ *ex-officio*, si dhe anëtarët e KPK deklaruan mos pasjen e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

Sipas Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i cili ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, dhe hetimit të thelluar të KPK, rezulton se subjekti ka kryer deklaram të saktë të pasurisë, nuk ka fshehje të të ardhurave dhe nuk është gjendur në konflikt interesi.

KPK vlerëson se pas një analize financiare të thellë dhe të plotë, subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme të ardhurash për të justifikuar pasurinë e deklaruar.

Sipas DSIK subjekti i rivlerësimit, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar duke konfirmuar përshtatshmërinë për vazhdimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me vlerësimin profesional, nga KLD janë administruar raporte dhe vlerësimet për subjektin e rivlerësimit të cilat mbajnë vlerësimin *shumë mirë*.

Pranë KPK janë paraqitur pesë denoncime për subjektin e rivlerësimit, në lidhje me fshehje pasurie të mundshme në emër të vëllait të subjektit. KPK referon se ka kryer një hetim të thelluar dhe të plotë në lidhje me pasuritë e të vëllait të subjektit, i cili rezulton të ketë aftësi të mjaftueshme financiare për disponimin e këtyre pasurive. Denoncimet e tjera ishin në lidhje me konflikte të mundshme interesi nga ana e subjektit të rivlerësimit. KPK vlerëson se subjekti ka qene i kujdesshëm në deklarimin e konfliktit të interesit dhe ka marrë masa duke u dorëhequr nga dosjet e hetimit ku kishte konflikt interesi.

Gjatë seancës KPK, kërkoi që subjekti i rivlerësimit të paraqesë dokumentet përkatëse vërtetuese të ardhura nga SHBA të cilat justifikojnë, burimin e borxhit nga kunati i subjektit në shumat 8,000 \$ dhe 12,000 \$. Subjekti i rivlerësimit, shprehet se për arsye të kohës së shkurtër për të siguruar dokumentacionin në SHBA dhe nxitimit për apostilimin e tyre nga ana e familjarëve në SHBA dokumentet i disponon në formën origjinale si dhe një fotokopje të dokumentit të apostiluara ditët e fundit, të cilat nuk kanë mbërritur akoma në Shqipëri mund të vihen në dispozicion në ditët në vijim. Subjekti i rivlerësimit vëren se gjetjet dhe analiza hetimore administrative e KPK është e saktë dhe e drejtë dhe kërkoi konfirmim në detyrë.

Trupi gjykues i përbëre nga Olsi Komici (kryesues); Valbona Sanxhaktari(relatore); Roland Ilija(anëtar), me datë 30 Prill 2019, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datë 26 Prill, shpallën vendimin duke konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, Znj. Elidiana Kasa, drejtuese e Prokurorisë së Rrethit gjyqësor Pukë.